



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2021:079404

Datë: 08.02.2024

Numri i dokumentit: 05300534

CP.nr.413/22

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve N.L., H.H., , R.D., dhe N.R., që të gjithë nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, kundër debitorës së përmbarimit Komunës së Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.552/21 të datës 16.05.2022, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit të ushqimit dhe udhëtimit në punë, në shumën e përgjithshme prej 4,276.90 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, më 08 shkurt 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me Aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.413/22 të datës 03.08.2022, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.552/21, të datës 16.05.2022, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit të ushqimit dhe udhëtimit në punë, dhe atë:

- kreditorës N.L., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 788.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 159.85 euro,

- kreditorit H.H., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 788.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 159.85 euro,

- kreditores R.D., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 788.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 159.85 euro,

- kreditores N.R., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 194.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 39.35 euro,

si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbartimore në shumën prej 1,200.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 4,276.90 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitorës së përmbartimit, Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve av. Arben Biblekaj në xhirollogarinë e tij bankare, me Nr.... pranë Bankës Kombëtare Tregtare - BKT.

II. OBLIGOHET pala kreditore dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

### A r s y e t i m

Gjykata aktvendimin CP.nr.413/22 të datës 03.08.2022, me të cilin e ka caktuar përmbartimin në këtë çështje përmbartimore, ia ka dërguar të paditurës, mirëpo e njëjta brenda afatit ligjor nuk ka ushtruar prapësim.

Meqenëse palët kreditore në propozimin e tyre për përmbartim, kanë cekur mjetin e përmbartimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, përkatësisht t'ia paguaj kreditores N.L., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 788.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 159.85 euro, kreditorit H.H., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 788.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 159.85 euro, kreditores R.D., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 788.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 159.85 euro, kreditores N.R., nga Gjakova, t'ia

paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 194.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 39.35 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbartimore në shumën prej 1,200.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 4,276.90 euro, dhe atë për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, CP.nr.413/22, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbartimit – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.552/21, të datës 16.05.2022, i plotfuqishëm me datë 16.06.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 28.06.2022, për shkak të detyrimit në të holla, duke u bazuar në dokumentin e lartcekur të përmbartimit, si dhe nenin 152 të LPP-së, debitorja, është e obliguar që kreditorit të përmbartimit, t'ia paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lart kjo gjykatë, vendosi që ta urdhëroj Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata duke u bazuar në nenet 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm-

CP.nr.413/22, më 08 shkurt 2024

GJYQTARI,

Durim BALAJ

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.